



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE
NDËRMARRJA E PASURISË PUBLIKE
SEKTORI I PROKURIMEVE

NR____prot

DATA:27/02/2026

PROCESVERBAL – TIPI I KONTRATËS – MALLRA

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “BLERJE GOMA”-FURNIZIM VENDOSJE.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): Goma për automjete të rënda / të lehta 34350000-5

Fondi limit/vlera e pritshme e kontratës: 4,956,484(katër milionë e nëntëqind e pesëdhjetë e gjashtë mijë e katërqind e tetëdhjetë e katër) LEKË PA TVSH.

Vlera e fondit limit është përcaktuar bazuar në mesataren e tre ofertave të marra nga grupi i punës i ngritur me Urdhërin Nr 45.prot datë:25/02/2026 ,konform nenit 34, 35 dhe 36 të Ligjit Nr 162/2021 “Për Prokurimin Publik”.

Vënë në dispozicion nga: Vetëfinancim + Buxheti i shtetit.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, Autoriteti/enti kontraktor, Ndërmarrja e Pasurisë Publike, ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

a.Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8

b. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3.

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen me Nenin⁷⁶ "Kriteret detyruese për skualifikim" Nenin 82 "Formulari përmbledhës i vetdëklarimit" dhe Neni 83 "Sigurimi i ofertës", të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" si dhe në mbështetje të nenit 26 "Formulari përmbledhës i vetdëklarimit" dhe nenit 30, pika 1, të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik:

Neni 82, i LPP "1. Bashke me dorezimin e kërkesave për pjesëmarrje ose të ofertave, autoritetet ose entet kontraktore pranojnë si prove paraprake në vend të disa vertetimeve të lëshuara nga autoritetet publike ose pale të treta, formularin përmbledhës të vetdëklarimit, sipas parashikimeve të këtij ligji. Përmbajtja e këtij formulari përcaktohet në rregullat e prokurimit publik".

Neni 83 i LPP "Autoriteti kontraktor duhet të kërkojë paraqitjen e sigurimit të ofertës nga ofertuesit në të gjitha llojet e procedurave të prokurimit, me përjashtim të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël".

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

- EN-ISO 9001 2015 (Sistemi i menaxhimit të cilësisë) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (në lidhje me objektin e tenderit).
- Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi konformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Argumentim: Kërkesat e cilësisë të përcaktuara janë vendosur në mbështetje të Ligjit Nr. 162/2020 "Për Prokurimin Publik", Neni 79, pika 1 ku citohet se: "Autoriteti ose enti kontraktor për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë", si dhe në zbatim të Neni 44, pika 1 dhe pika 3 të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Autoriteti/enti kontraktor, për të vërtetuar se punët, mallrat ose shërbimet, objekt prokurimi, i plotësojnë kërkesat e cilësisë, mund t'u kërkojë ofertuesve të paraqesin certifikata të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, vetëm nëse ato janë të argumentuara dhe të lidhura ngushtësisht dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë me objektin e prokurimit".

ISO 9001:2015 është një seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se çdo ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogëlimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me çmime të ulta.

2.2.Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin Kopje të deklaratave të xhiros vjetore për vitet financiare 2022, 2023, 2024 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se 40 % e vlerës së parashikuar të kontratës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit Nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik" në të cilin gjejmë të përcaktuar se: " *Në lidhje me situatën ekonomike dhe financiare, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë kanë kapacitetin e nevojshëm ekonomik dhe financiar për të zbatuar kontratën. Për këtë qëllim autoritetet ose entet kontraktore mund të kërkojnë në veçanti që operatorët ekonomikë të kenë një xhiro vjetore minimale të caktuar.. Xhiroja vjetore minimale që kërkohet nga operatorët ekonomikë nuk mund të tejkalojë dyfishin e vlerës së parashikuar të kontratës*", në pikat 1,2 (b) ,3 të nenit 43, si dhe në nenin 55 pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar.

Vendosja e këtij kriteri bëhet me qëllim që Autoriteti Kontraktor të sigurohet për aftësinë ekonomike dhe financiare të OE ofertues, duke vërtetuar nëpërmjet dokumenteve të kërkuara, se zotërojnë kapacitet ekonomik dhe financiar për të përmbushur kontratën sic është parashikuar nga AK. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në Ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar,. Në përcaktimin e vlerës së xhiros autoriteti kontraktor është referuar në pikën 2, gërma (c) të Nenit 43, Seksioni III të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Aftësitë teknike dhe profesionale:

2.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për realizimin me sukses të një ose disa kontratave të mëparshme, të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të madhe se 20 % të vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë kontratën e nënshkruar, vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara,
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77(c) të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 55, pika 4b, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar.

Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më të madhe se 20 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

2.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim prodhuesi, ose marrëveshje bashkëpunimi me prodhuesin, ose autorizim distributori për tregtimin e mallrave objekt prokurimi në territorin e RSH. Në rastin e autorizimit të distributorit, duhet paraqitur dhe marrëveshja midis distributorit të autorizuar dhe prodhuesit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë:19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kriterë të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”. Ky kriter është vendosur për të garantuar sigurinë e origjinës dhe cilësisë. Autorizimi provon që ofertuesi furnizohet nga burim zyrtar dhe që është produkt origjinal dhe jo i falsifikuar. Gjithashtu autorizimi është kërkuar dhe për t’i dhënë siguri AK-së se mallrat e ofertuar i përmbushin specifikimet teknike të kërkuara.

2.5 Operatori ekonomik duhet të paraqesë deklaratë mbi garancinë e gomave.

Garancia e kilometrazhit të përshkruar në shfrytëzim normal sipas kushteve teknike të shfrytëzimit do të jetë:

- a) Goma në përdorim kamionçina: jo më pak se 60000 km.
- b) Goma në përdorim për kamion: jo më pak se 80000 km.
- c) Goma në përdorim për automjetet industriale (fadroma, vinc): jo më pak se 8000 orë pune.

Operatori ekonomik i shpallur fitues gjatë periudhës së garancisë është i detyruar të kryejë zëvendësimin e gomave me difekt për shkak të prodhimit ose cilësisë së dobët, pas marrjes së njoftimit nga Autoriteti Kontraktor.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se “Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.

Kërkesa për garanci të gomave është vendosur për të siguruar cilësinë, sigurinë dhe jetëgjatësinë funksionale të mallrave të furnizuara, si dhe për të mbrojtur interesin ekonomik të Autoritetit Kontraktor. Gomat janë element kritik për sigurinë e qarkullimit dhe për vazhdimësinë e shërbimeve; defektet e prodhimit ose moskonformitetet teknike mund të shkaktojnë ndërprerje të punës së mjeteve, rrezik për përdoruesit dhe kosto shtesë operative.

Garancia e kërkuar detyron operatorin ekonomik të furnizojë produkte që përmbushin specifikimet teknike dhe standardet e cilësisë, si dhe të zëvendësojë ose riparojë pa kosto çdo gomë me defekt që rrjedh nga prodhimi ose materiali, brenda periudhës së garancisë. Kjo kërkesë rrit përgjegjshmërinë e operatorit ekonomik, ul rrezikun e furnizimit me produkte nën standard dhe siguron performancë të qëndrueshme të mjeteve në shërbim.

Kërkesa për garanci është proporcionale me natyrën e kontratës “blerje goma – furnizim dhe vendosje”, lidhet drejtpërdrejt me objektin e saj dhe është e nevojshme për garantimin e përdorimit të sigurt dhe efikas të mjeteve.

2.6 Operatori ekonomik të paraqesë katalogë / broshurë / skedë teknike të prodhuesit për artikujt objekt prokurimi ku të përfshihen specifikimet teknike të tyre. Operatori ekonomik duhet të markojë në katalog / broshurë / skedë teknike (për lehtësi identifikimi) artikujt dhe specifikimet teknike sipas atyre të përcaktuara në Specifikimet Teknike, në mënyrë që të verifikohet përputhshmëria e tyre me dokumentet e tenderit. Dokumenti duhet të jete në gjuhën shqipe ose i përkthyer dhe noterizuar në gjuhë shqipe.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” nenit 40, pika 6, gërma b,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: fotografitë apo katalogët teknikë”*

Kërkesa për paraqitjen e katalogut, broshurës ose skedës teknike të prodhuesit për gomat e ofruara është vendosur për të verifikuar përputhshmërinë e ofertës me specifikimet teknike të kërkuara dhe për të siguruar cilësinë dhe performancën e mallrave të furnizuara. Dokumentacioni teknik i prodhuesit mundëson identifikimin e qartë të karakteristikave kryesore të gomave (dimensionet, indeksi i ngarkesës dhe shpejtësisë, përbërja, standardet dhe certifikimet, performanca në kushte të ndryshme, etj.), duke garantuar që produktet e ofruara janë të përshtatshme për përdorimin e synuar.

Kjo kërkesë rrit transparencën dhe objektivitetin në vlerësimin e ofertave, pasi lejon krahasimin e drejtpërdrejtë të parametrave teknikë midis produkteve të ndryshme dhe shmang rrezikun e furnizimit me mallra nën standard ose jo-konforme.

2.7.Operatori ekonomik duhet të sigurojë shërbim ndërhyrjeje emergjente në terren për zëvendësimin e gomave të mjeteve të Autoritetit Kontraktor, në çdo kohë (24 orë/7 ditë), përfshirë orarin e natës dhe ditët jo-pune, me paraqitje në vendndodhjen e mjetit.

-Për garantimin e kesaj, operatori ekonomik duhet të disponojë ambient servisi funksional në pronësi ose me qera brenda territorit të Bashkisë Lushnje;

OSE:

-nëse nuk disponon ambient servisi në pronësi ose me qera, duhet të paraqesë kontratë bashkëpunimi të vlefshme me një subjekt që disponon ambient servisi brenda këtij territori, e cila mbulon të gjithë periudhën e kontratës dhe garanton ofrimin e shërbimit emergjent sipas kushteve të kërkuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40 (pika 8) të VKM nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ku përcaktohet se: *“Autoriteti/enti kontraktor, përveç kërkesave të parashikuara në këtë nen, mund të përcaktojë kritere të tjera të veçanta, në varësi të objektit që prokurohet, të cilat i vlerëson të nevojshme për ekzekutimin me sukses të kontratës”.*

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë pikë shërbimi funksionale brenda territorit të Bashkisë Lushnje (ose, në mungesë të saj, të paraqesë kontratë bashkëpunimi me një subjekt që disponon ambient servisi në këtë territor) lidhet drejtpërdrejt me garantimin e kohës së reagimit.

Vendndodhja lokale mundëson mobilizim të menjëhershëm të personelit dhe mjeteve, ul kohën e udhëtimit dhe siguron ndërhyrje efektive në raste emergjente. Parashikimi i kontratës së bashkëpunimit shmang kufizimin e panevojshëm të konkurrencës, duke lejuar pjesëmarrjen e operatorëve që nuk kanë ambient në pronësi, por që mund të garantojnë shërbimin përmes një marrëveshjeje të vlefshme dhe të zbatueshme.

2.7.1.Operatori ekonomik duhet të provojë se disponon personel të mjaftueshëm dhe të kualifikuar për realizimin e kontrates, duke patur të paktën 1 (një) punonjës me profesion mekanik e provuar me:

a)Çertifikatë/Diplomë/Dëshmi kualifikimi që vërteton nivelin e kualifikimit arsimor, lëshuar nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar;

b)kontratën individuale të punës ose deklarate angazhimi.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e

operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës”, si dhe në Nenin 40, pika 5, germa (c) të VKM Nr.285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”*.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë të paktën 1 (një) mekanik të kualifikuar për shërbime gomash është vendosur për të garantuar realizimin teknik, të sigurt dhe në kohë të vendosjes, zëvendësimit dhe/ose riparimit të gomave, si në servis ashtu edhe në terren. Ndërhyrjet në goma kërkojnë njohuri dhe aftësi profesionale për përdorimin e pajisjeve specifike, respektimin e standardeve të sigurisë dhe shmangien e dëmtimeve të mëtejshme të mjetit.

Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë kontratë pune ose deklaratë angazhimi për mekanikun, si dhe certifikatë/diplomë/dëshmi kualifikimi profesional, është vendosur për të provuar realisht disponueshmërinë dhe kompetencën profesionale të personelit që do të realizojë vendosjen, zëvendësimin dhe/ose riparimin e gomave në servis dhe në terren.

Kontrata e punës ose deklarata e angazhimit siguron që mekaniku është i lidhur efektivisht me operatorin ekonomik dhe i disponueshëm gjatë gjithë periudhës së kontratës, veçanërisht për ndërhyrje emergjente 24/7. Dëshmia e kualifikimit profesional verifikon aftësitë teknike për përdorimin e pajisjeve specifike, respektimin e procedurave të sigurisë dhe realizimin korrekt të shërbimit, duke ulur rrezikun e ndërhyrjeve jo-profesionale dhe të kostove shtesë.

2.8.Operatori ekonomik duhet të disponojë automjet shërbimi të dedikuar për ndërhyrje në terren me të gjitha pajisjet e domosdoshme për montim/cmontim gome.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa (ç) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se:*“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”*.

Kërkesa që operatori ekonomik të disponojë automjet shërbimi të dedikuar për ndërhyrje në terren është vendosur për të garantuar realizimin në kohë dhe në kushte sigurie të zëvendësimit dhe/ose riparimit të gomave të mjeteve të Autoritetit Kontraktor, në çdo kohë (24/7), përfshirë orarin e natës dhe ditët jo-pune.

2.8.1.Për automjetin e shërbimit duhet të paraqitet:

-Leje qarkullimi

-Certifikatë pronësie ose kontratë qiraje e vlefshme për të gjithë periudhën e kontratës.

-Siguracion i detyrueshëm i vlefshëm.

Të gjitha kostot e transportit, ndërhyrjes dhe vendosjes së gomës përfshihen në çmimin e ofertës.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është vendosur sipas pikës 4, të Nenit të 77, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, si dhe Kreut V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa (ç) të VKM Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” ku përcaktohet se: *“Për të provuar përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale, kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti/enti kontraktor kërkon: mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t’i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën, të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit”*.

Leja e qarkullimit provon që automjeti është i regjistruar dhe i lejuar për përdorim në rrugë, duke garantuar ndërhyrje të menjëhershme dhe të ligjshme në terren.

Certifikata e pronësisë ose kontrata e përdorimit vërteton se operatori ekonomik ka të drejtë të disponojë mjetin gjatë gjithë periudhës së kontratës, duke shmangur pasiguri mbi disponibilitetin e tij.

Siguracioni i vlefshëm garanton mbulimin e rreziqeve gjatë qarkullimit dhe ndërhyrjeve, duke mbrojtur interesin publik dhe të Autoritetit Kontraktor.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara. Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente false dhe të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.

Ofertuesi i kualifikuar i pari duhet të dorëzojë përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe brenda afatit të përcaktuar në kërkesën për dorëzim dokumentacioni pranë AK, dokumentet provuese për vetëdeklarimet në formularin përmbledhës të vetëdeklarimit të parashikuara në pikën 2 të nenit 26 të VKM-se 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, si dhe dokumentet e tjera shoqëruese të ofertës, të dorëzuara në rrugë elektronike. Këto dokumente duhet të paraqiten në origjinal ose në kopje të njësuar me origjinalin.

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për mallrat objekt prokurimi, të cilat duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar, dhe që i vlerëson mallrat si të pranueshme për funksionet e kërkuara, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 40, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose

originë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

NJËSIA E PROKURIMIT